



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS FIER

Nr. 822 Prot.

Fier, më 15/12/2021

Lënda : Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimi i kontabilizimit i detyrimeve doganore)

PREFEKTIT TË QARKUT - FIER

Duke vlerësuar me kënaqësi bashkëpunimin e deritanishëm ndërmjet institucioneve tona, në bashkërendimin e veprimeve për zgjidhjen e problemeve të dyanëshme, si dhe me synimin e përmbushjes së misioneve tona të ngarkuara nga Ligji, e shohim të domosdoshëm forcimin e mëtejshëm të këtij bashkëpunimi, pasi nga ana jonë konstatohet se në shume raste nëpërmjet Tij, është mundësuar shlyerja e borxhit doganor.

Në respektim të Ligjit Nr.102, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, neni 48/4 i Tij “Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve” - “Institucionet publike dhe strukturat e Policisë së Shtetit ndihmojnë autoritetet doganore sa herë që këto të fundit kërkojnë ndihmën e tyre për zbatimin e legjislacionit doganor, në përputhje me funksionet dhe kompetencat e tyre”, në zbatim të Ligjit Nr.8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile”, neni 131 i Tij “Kur nuk është i mundur njoftimi sipas dispozitave të mësipërme, njoftimi bëhet në vendbanimin apo vendqëndrimin e marrësit ose në zyrën apo vendin ku ushtron veprimtarinë tregtare, industriale....”, nenit 162/2 të Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” - “Njoftimi publik bëhet nëpërmjet shpalljes së shkresës në një kënd të posaçëm për njoftimet në selinë e organit dhe në degët ose në zyrat e tij vendore, në prefekturën apo në një vend tjetër dhe ku mendohet se mund të merret dijeni nga ai/ajo, të cilit i drejtohet”, si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr. 15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të

papaguara doganore dhe të akcizës”, pika VI.3.b e Tij, “Kur nuk gjendet adresa apo nuk dihet vendndodhja e subjektit debitor, apo ky i fundit nuk gjendet me adresën e kërkuar, njoftimi mund të bëhet edhe përmes lajmërimit publik. Këto njoftime do të vihen në stendën e krijuar posaçërisht për njoftim.....si dhe në vende publike si në Bashki, Njësi Administrative, në gazetën e pushtetit vendor, në internet dhe me mjete të tjera audiovizive etj. Në këto raste pas kalimit të një periudhe 30 ditore, subjekti debitor konsiderohet i njoftuar”. kërkojmë nga ana Juaj :

♦ **“Shpalljen Publike”** për një periudhë kohore jo më pak se 30 (Tridhjetë) ditë të aktit administrativ – Vendimit të Kontabilizimit të detyrimeve doganore si vijon:

Nr.134, me Nr.3448/5 Prot., datë 18/11/2016, i materializuar për subjektin “KASA” sh.p.k, me Nipt J93512406K, me seli në Fier (Portëz), me përfaqësues ligjor znj.Bukurie Kasaj.

Bashkëngjitur, gjeni kopje të aktit të lartpërmendur – gjithsej 1 (një) fletë.

Jemi në pritje të konfirmimit nga ana Juaj për datën e shpalljes së aktit të lartpërmendur.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETAR

Roland Mërtiri





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANES FIER

Nr. 3448/1 - Prot

Fier më 18 / 11 / 2016

VENDIM

Nr. 3448.... Dt. 18.11.2016

Sot autoriteti vendimmarres i Deges se Doganes Fier u njoh me procesverbalin nr. 0011701 te dates 03.10.2016, mbajtur nga Hetues Doganor, ardhur me shkresen nr.13237/4 dt. 19.08.2016 "Informacion per marrje vendimi" protokolluar me tonen nr 3448/2 date 25.08.2016 per verifikimin shkeljes doganore te cilesuar si **Kundervajtje Administrative**, si dhe shkresen nr. 13277/1 dt. 05.10.2016 me lende:Dergohet proces verbali per verifikimin e kundravajtjes Administrative, protokolluar me tonen nr. 3448/4 dt. 25.10.2016 ku eshte pasqyruar shkelja doganore qe i perket subjektit "**KASA me N.I.P.T. nr. J93512406K**", ku nga kontrolli i ushtruar ka.rezultuar:

Nga kontrolli i ushtruar nga OPGJ te Drejtorise se Hetimit prane Drejtoriasse se Pergjitheshme te Doganave, prane subjektit "**KASA me N.I.P.T. nr. J93512406K**" u konstatua se ka mbajtur te depozituar dhe magazinuar materiale hidrokarbure, si Nafte bruto, lende djegese Solar dhe mbetje vajrash megjithese nuk gezon statusin e magazines fiskale te prodhimit, Stokimit, siç parashikohet nga ligji nr. 61/2012 "Per Akcizat ne Republiken e Shqiperise"i ndryshuar.

Keshtu jane mbajtur ne kushtet e paligjishmerise; 1- Lende djegese 40.700 litra, 2- Vajra te naftes bruto 4.960 litra dhe 3- Mbetje vajrash 8.500 litra, sasi te cilat janr sekuestruar dhe referuar Prokurorise prane Gjykates se Shkalles se Pare Fier.

Konstatimet e me sipërme perbejne shkeljete neneve 2.4.3.a,7/a.19,30.85/1a,85/2, 86/2 dhe 96 te ligjit. nr. 61/2012 "Per Akcizat ne Republiken e Shqiperise"i ndryshuar

Per kete eshte propozuar qe subjekti te paguaj detyrimin doganor te Akcizes dhe te penalizohet me gjobe .

Per keto arsye , mbeshtetur ne procesverbalin e verifikimit , autoriteti vendimmarres i Deges se Doganes Fier e gjen te drejte zbatimin e neneve te mesiperm dhe ne baze te nenit 109/1 te Kodit te Procedures Administrative ,nenit 2.4.3.a,7/a.19,30.85/1a,85/2, 86/2 dhe 96 te ligjit. nr. 61/2012 "Per Akcizat ne Republiken e Shqiperise"i ndryshuar, ndaj ketij subjekti.

VENDOSI:

Te paguaj detyrimin Doganor te Akcizes ne shumen	ne shumen 2.215.033 leke
Te denoje me gjobe (2 fish i detyrimiot) ne shumen	4.430.066 leke
TOTAL	6.645.099 leke

Kunder ketij vendimi mund te behet ankim tek Drejtori i Pergjitheshem Brenda 30 diteve nga data e komunikimit te ketij vendimi.sipas nenit 105 te Ligjit nr. 61/2012, i ndryshuar per "Akcizen ne Republiken e Shqiperise".

Edison KONOMI

KRYETAR